VENDIM
Nr. 751, datë 1.12.2022

PËR NJË MBROJTJE TË VEÇANTË NGA SHTETI PËR GRATË E PAPUNA ME TRE APO MË SHUMË FËMIJË TË MOSHËS DERI NË 18 VJEÇ *DHE NDIHMËSIT PERSONALË TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA*

(Ndryshuar me VKM nr. 592 ,datë 22.7.2026)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 58, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Grave të papuna me tre apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç, ku njëri prej fëmijëve është nën moshën 5 vjeç dhe familja ka të ardhura nën 100 000 (njëqind mijë) lekë në muaj, periudha e kujdesit ndaj fëmijës deri në moshën 5-vjeçare njihet si periudhë sigurimi për efekt përfitimi pensioni pleqërie dhe barrëlindjeje.

1/1. Ndihmësve personalë të personave me aftësi të kufizuara, sipas shkronjave "b" dhe "c", të nenit 8, të ligjit nr. 57/2019, "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, që nuk janë ekonomikisht aktivë dhe nuk përfitojnë të ardhura nga skema e sigurimit të detyrueshëm të sigurimeve shoqërore, periudha e kujdesit ndaj personave me aftësi të kufizuara u njihet si periudhë sigurimi, për efekt përfitimi pensioni pleqërie dhe barrëlindjeje.

1/2. Ndihmësve personalë të përfituesve, sipas nenit 5, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, "Për statusin e të verbrit", të ndryshuar, që nuk janë ekonomikisht aktivë dhe nuk përfitojnë të ardhura nga skema e sigurimit të detyrueshëm të sigurimeve shoqërore, periudha e kujdesit ndaj të verbërve u njihet si periudhë sigurimi, për efekt përfitimi pensioni pleqërie dhe barrëlindjeje.

2. Kontributet e sigurimeve shoqërore për degën e sigurimit të pensioneve dhe degën e sigurimit të barrëlindjes paguhen në nivelin e pagës minimale në shkallë vendi.

3. Shërbimi Social Shtetëror përcakton listën e grave që përfitojnë mbrojtje të veçantë dhe çdo muaj llogarit dhe kryen pagesën e kontributeve, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003, "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të udhëzimit të ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe çështjet sociale.

3/1. Bashkitë përcaktojnë listat e ndihmësve personalë dhe çdo muaj llogarisin e kryejnë pagesën e kontributeve, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003, "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të udhëzimit të ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe çështjet sociale.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

5. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për zbatimin e këtij vendimi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet nga data 1 janar 2023.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku